

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org.Unit Nr. i Faqeve Br. Stranica NaPages	8P.02 -03. Nr. i Prot. Prot. No Data: Date:
25.09.25 25.09.25	7005-2/25 25.09.25
PRISHTINË / A No. 1	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	23.09.2025
REFERENC-Ë:	25/7005/MMPHI
PËR/ZA/TO:	Kompanisë "Euroasphalt" SH.p.k. Gjakovë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin e dorëzuar të Kompanisë Kompanisë "Euroasphalt" SH.p.k. Gjakovë, me nr. prot. 25/7005/577/DMM dhe pas shqyrtimit kësaj letërpërcjellëse ja bashkangjesim njoftimin.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Njoftim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën e dorëzuar të Kompanisë Kompanisë “Euroasphalt” SH.p.k. Gjakovë, lidhur me konfirmimin e validitetit të Pëlqimit Mjedisor nr. prot. 19/3236-1/ZSP/322/19, datë: 13.06.2019, për Impiantin për prodhimin e betonit, asfaltit dhe seperacionin në Marmullë, Komuna e Gjakovës, në parcelat kadastrale P-70705048-01205-2; 01206-0; 01224-3; 01207-2; 01220-2; 01207-1; 01220-1.

Bazuar në Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit Nr. 08/L-181, Neni 21, vlefshmëria e Vendimit për Pëlqim Mjedisor ndërpritet nëse brenda dy (2) vitesh nga data e pranimit të Vendimit për Pëlqimin Mjedisor aplikuesi nuk siguron lejen për ndërtim ose aprovimin për realizimin e projektit, dhe lokacioni ku projekti duhet realizuar nuk është përgatitur e as nuk është nisur ndonjë aktivitetet operativ.

Referuar përshkrimit në kërkesë pala ka bashkangjitur edhe dokumentacionin mbështetës me qka konfirmohet se i njeiti ka plotësuar kushtet e kërkuara me legjislacionin në fuqi (Certifikatën e regjistrimit të biznesit, Pëlqimi mjedisor me nr. prot. 19/3236-1/ZSP/322/19, datë: 13.06.2019; Lejen për Aktivitete të Veqanta nga KPMM 601/KPMM/2018 për bazë asfalti me nr. prot. 2498, të datës 01.08.2018 dhe Lejen për Aktivitete të Veqanta nga KPMM 602/KPMM/2018 për bazë betoni me nr.

prot. 2497 të datës 01.08.2018; Vendimin për aprovim të kërkesës nga KPMM me nr. prot. 2675 të datës 26.08.2025; si dhe fotografi nga tereni).

Investitori gjithashtu ka deponuar në DMMU edhe Deklaratën nën betim për origjinalitetin e dokumenteve të dorëzuara.

Bazuar në të lartëcekurat MMPHI njofton Kompaninë "Euroasphalt" SH.p.k. Gjakovë se Pëlqimi Mjedisor 19/3236-1/ZSP/322/19, datë: 13.06.2019 është **Valid**.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë në afat 30 ditësh nga dita e pranimet e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr. prot. 25/7005/ ZSP/ /25 datë: 23.09.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komunës së Gjakovës
3. Komisionit për VNM
4. Inspektoratit
5. Kabinetit të Ministrit
6. Divizioni për komunikim me publikun
7. Arkivit të MMPHI



UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI